

KURSI SCRATCH

cacttukids»



PERSHKRIMI I KURSIT

Scratch është projekt i MIT Media Lab, i cili është një laborator kërkimor i Institutit të Teknologjisë të Massachusetts, i përkushtuar për projektet që kanë të bëjnë me konvergencën e teknologjisë, multimedia, shkenca dhe dizajn.

Me anë të Scratch, fëmijët mund të programojnë storjet e tyre interaktive, lojërat dhe animacionet, e të cilat mund t'i ndajnë me komunitetin online dhe shoqërinë e tyre. Scratch u ndihmon të rinjve të mësojnë se si të mendojnë në mënyrë kreative, kritike dhe të punojnë në ekip, e cila mund të thuhet se është një aftësi thelbësore për jetën në shekullin e 21-të.

PSE TE PERZGJIDHET KURSI SCRATCH?

Në CacttuKids, fëmijët dhe adoleshentët kanë mundësi të programojnë me Scratch me ndihmën e instruktorëve profesional të kësaj fushe.

E shtuna në CacttuKids, i takon eksperiencave të reja, eksplorimit të botës së teknologjisë dhe krijimit të projekteve që vijnë nga imagjinata e secilit fëmijë.

DEDIKIMI DHE KOHËZGJATJA

- Moshë: 12-15 vjeç
- Numri i orëve: 32 orë
- Çmimi : 88 €



KURSI SCRATCH



PSE TË PËRZGJIDHET KURSI SCRATCH NË CACTTUKIDS?

Scratch është projektuar për të qenë argëtues, edukativ dhe i lehtë për t'u mësuar. Në Scratch përdoren mjete për krijimin e storjeve interaktive, lojërave, artit, simulimeve dhe më shumë, duke përdorur programimin me anë të blloqeve. Po ashtu, Scratch ka edhe editorin e vet të ngjyrave dhe audios.



Trajnimet me anë të gjuhës programuese Scratch përdoren kryesisht për një sërë qëllimesh arsimore dhe argëtuese duke u nisur nga projektet e matematikës dhe shkencës, deri tek storjet e animuara të shkencave shoqërore dhe artit interaktiv.

Përdoruesit programojnë në Scratch duke zvarritur blloqet nga paleta dhe duke i bashkangjitur ato në blloqe të tjera, e cila i ngjanë një lojë "puzzle". Këto struktura të blloqeve të bashkuara quhen skripta.

NDIQENI @CACTTUKIDS NË:



1.5k+



290+

Kjo metodë e programimit (kodimi përmes blloqeve) quhet ndryshe "programim drag-and-drop".